

6.2 LLOJET E TË DHËNAVE

6.2.1 Data

Data vendose në formën **dd.mm.vvvv**.

Vendosjen automatike të datës e mundësojnë tastet <D>, <W> dhe <M>.

Duke shtypur tastin <D> në fushën përkatëse vendoset data aktuale. Sa herë që shtypni këtë tast vendoset një datë më e re. Nëse shtypni njëherësh tastin <Shift> + <D> në fushë vendoset data që është për një ditë më e vjetër se data aktuale. Sa herë që këto dy taste i shtypni njëherësh vendoset një datë për një ditë më e vjetër se data aktuale.

Duke shtypur në tastin <W> në fushë vendoset data, e cila është një javë më e re se data aktuale. Sa herë që shtypni këtë tast vendoset data një javë më e re se data aktuale. Nëse shtypni njëherësh tastin <Shift> + <W> në fushë vendoset data që është për një javë më e vjetër se data aktuale. Sa herë që këto dy taste i shtypni njëherësh vendoset një datë për një javë më e vjetër se data aktuale.

Duke shtypur tastin <M> në fushë vendoset data, e cila është një muaj më e re se data aktuale. Sa herë që shtypni këtë tast vendoset data një muaj më e re se data aktuale. Nëse shtypni njëherësh tastin <Shift> + <M> në fushë vendoset data që është për një muaj më e vjetër se data aktuale. Sa herë që këto dy taste i shtypni njëherësh vendoset një datë për një muaj më e vjetër se data aktuale.

Data e vendosur fshihet duke shtypur tastin për hapësirë.

6.2.2 Numrat e telefonit dhe faksit

Para numrit të telefonit dhe të faksit duhet të shënohet numri i rrjetit telefonit dhe pas saj të vendoset hapësirë.



Shembuj:

038 200 24 131

(02) 5375789

Në fushë mund të shënoni disa numra, mirëpo mes vete duhet të jenë të ndarë me: hapësirë, simboli "/", hapësirë. Lejohet edhe shënimi i shkurtesës për numrin e brendshëm "int.".



Shembuj:

03 5375 789 / 5449 651 / 044 654 876
(02) 5375789 int. 776

Te numrat që vlejné jashtë vendit vendoset simboli "+", prefiksi i shtetit dhe më pas numri i personit ose i institucionit (te numrat që vlejné brenda vendit, simboli "+" dhe prefiksi i shtetit shtohen në mënyrë automatike, kur konfirmoni shënimin ose kur kaloni në fushën tjetër për shënimin e të dhënave).



Shembuj:

+31 152 571 796 – numri i telefonit në Holandë (Delft)
+43 1 534 10 – numri i telefonit në Austri (Vjenë)

6.2.3 Adresat elektronike

E dhëna e shënuar në fushën për adresën elektronike patjetër duhet të përmbaj simbolin "@".

6.2.4 Vlerat dhjetore

Vlerat dhjetore ndahen me presje.

6.2.5 Shumat

Shumat shënohen pa pikat, të cilat ndajnë pjesët e numrave.



Shembuj:

Shuma 1.540,00 shënohet si 1540,00.
Shuma 5.875,25 shënohet si 5875,25.

6.2.6 Fjalëkalimet

Gjatë hyrjes në program duhet të keni kujdes në përdorimin e shkronjave të vogla dhe të mëdha, sepse programi i dallon ato.